

**AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"Hashtag Solutions" SHPK,**

Ne Tirane, sot me date 03.09.2018, u mblodhën ortaket themelues si më poshtë:

- 1- **Z.Besjan Pesha**, shtetas shqiptar, i biri i Sevo-s, lindur ne Gjirokaster me 09.08.1980, banues ne Tirane ne adresen: Rruga Hamdi Sina, Kompleksi Gjelberimi mbajtes i leternjoftimit me nr. I00809084E me date skadence te leternjoftimit 21.05.2028 madhor e me zotesi te plote juridike e per te vepruar;
- 2- **Z.Albert Pesha**, shtetas shqiptar,i biri i Savo-s, lindur ne 06.10.1971 ne Gjirokaster banues ne Fier , me adresen Lagjia 15 Tetori,Rruga Alfred Gjini, Fier mbajtese i leternjoftimit me nr. H11006096N, me date skadence te leternjoftimit 24.02 2020 madhor e me zotesi te plote juridike e per te vepruar

Te cilet hartojne kete Akt Themelimi te shoqerise "**Hashtag Solutions**" SHPK me emer tregtar "**Hashtag Solutions**", mbeshtetur ne ligjin 9901 date 14.04.2008, "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", i ndryshuar, ligjin 9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, si me poshte:

KREU 1

Neni 1

Krijimi

Shoqeria "**Hashtag Solutions**" SHPK, eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqeria").

Neni 2

Personaliteti juridik

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendren Kombetare te Regjistrimit (QKR), në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqeria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Shoqëria "**Hashtag Solutions**" SHPK, eshte nje shoqeri, që themelohet ndërmjet ortakeve që përballojnë humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin themeltar

Neni 3

Selia



- Shoqeria e ka seline ne Tirane ne adresen Rruga " Jordan Misja, Pallati Sara-El, shkalla 1, kt2, ap4. ", Pasuria numer 23/58+1-N16, Lagjia Nr.4 Tirane.

Shoqeria mund te ndryshoje seline e tij, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojte filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetem me vendim te Ortakeve te Shoqerise.

Neni 4

Objekti i veprimtarise

Objekti i veprimtarise se kesaj shoqerie eshte:

Dixhitalizim i bizneseve, ndertim dhe mirembajtje faqesh interneti, ndertim dhe mirembajtje sistemesh dixhitale te menaxhimit te organizatave dhe bizneseve, sherbime marketing, sherbime dixhital, shitje dhe blerje online.

Neni 5

Kohezgjatja

Kohezgjatja e veprimtarise se Shoqerise "**Hashtag Solutions**" SHPK eshte e pakufizuar.

KREU II

KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 500.000 leke.

- a) Ortaku **Besjan Pesha** eshte zoterues i nje kuote me vlere nominale 250.000 leke (dyqind e pesedhete mije lekë), qe perben 50% te kapitalit themeltar.
- b) Ortaku **Albert Pesha** eshte zoterues i nje kuote me vlere nominale 250.000 leke (dyqind e pesedhete mije lekë), qe perben 50% te kapitalit themeltar.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme. Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).



Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cenimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cenimit të këtyre të drejtave. Kjo e drejtë parashkruhet brenda 3 vjetëve nga çasti i cenimit.

Neni 7

Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

1. a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
b) shitblerjes;
c) trashëgimisë;
ç) dhurimit;
d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.
1. Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.
2. Statuti mund të kushtëzojë kalimin e kuotave, veçanërisht duke përcaktuar miratimin e shoqërisë ose të drejtën e parablerjes në favor të shoqërisë apo të ortakëve të tjerë.
3. Në rastet e kalimit të kuotave me kontratë, kushtet dhe momenti i kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotën, si dhe kushtet e tjera të kalimit, përfshirë momentin e pagesës së çmimit, rregullohen nga kontrata. Kontrata për kalimin e kuotës hartohet në formë shkresore dhe noterizimi nuk përbën kusht për vlefshmërinë apo regjistrimin e kontratës. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet shprehimisht ndryshe nga ligji apo kur palët bien dakord në kontratë, vlefshmëria e kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotat nuk do të kushtëzohet nga kryerja e formaliteteve të ndryshme me efekt deklarativ, përfshi këtu formalitetet e regjistrimit ose të publikimit të kontratës apo të kalimit të titullit.

KREU III

ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimarrës

Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "ç" dhe "ç" të kësaj pike;



- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) Kreditimin në çfaredo banke apo institucion financiar kreditor.
- j) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9 Administrimi

Shoqeria do të administrohet nga **Z.Besjan Pesha** ..sipas statutit dhe ligjit për një periudhë 5 vjeçare me të drejtë ripërtëritje.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti, apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë.

Përveç kësaj, administratori shkarkohet nga gjykata për shkelje të ligjit me kërkesë të çdonjërit prej ortakëve.

Tagrat e përfaqësimit të administratorit dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.


Emërimi i administratorit prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Administrator i shoqërisë mund të emerohet edhe një person jashtë ortakërisë.

Neni 10 Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;



c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;

ç) përgatiti dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;

d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

ë) kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratori ka të drejte të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve, bankat e të gjitha niveleve etj. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, si përpara Bankave të të gjitha niveleve, për të kryer derdhje, terheqje, transferta, etj, përpara Zyrave të Tatimit Taksave, Zyrave të Qeverisjes Vendore, Zyrave të Punës, Autoriteteve Doganore, etj, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve të shoqërisë.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Neni 11 Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 12 Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 13 Mosmarreveshjet

Për mosmarreveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarreveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tjerëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.



Neni 14

Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua ne 4 ekzemplare me permbajtje dhe vlera te njejta juridike, ne gjuhen shqipe, u miratua ne parim nen per nen nga Ortaket e shoqerise tregtare "**Hashtag Solutions**" SHPK, nenshkruhet ne te gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen orgjinale, ne prani te noteres.

ORTAKET THEMELUES

TE SHOQERISE "Hashtag Solutions" SHPK

BESJAN PESHA

Handwritten signature of Besjan Pasha in black ink, written over a horizontal line.

ALBERT PESHA

Handwritten signature of Albert Pasha in black ink, written over a horizontal line.